Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 22 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenin 10 paragrafi 10.1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe bazuar në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit me numër Sh.02. nr. 6939 e datës 17.03.2026 për projektin “**Asfaltimi i rrugëve në Kamenicë dhe fshatra – Faza III (Roganë, Hodonoc, Koretin, Petrit, Tygjec, Kopernicë, Hogosht, Busavatë, Berivojcë, Karaqevë)**” dhe nenin 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Blerim Murina** Zyrtar Autorizues për projektin: **Asfaltimi i rrugëve në Kamenicë dhe fshatra – Faza III(Roganë, Hodonoc, Koretin, Petrit, Tygjec, Kopernicë, Hogosht, Busavatë, Berivojcë, Karaqevë)** ” Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t’i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
2. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit te Zyrtari i Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit, së bashku me kopjen e Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërinë për Disponueshmërinë e Fondeve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi është përgjegjës Zyrtari Autorizues, **z. Blerim Murina**, për projektin: “**Asfaltimi i rrugëve në Kamenicë dhe fshatra – Faza III(Roganë, Hodonoc, Koretin, Petrit, Tygjec, Kopernicë, Hogosht, Busavatë, Berivojcë, Karaqevë)** ”
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.


Vendimi t’i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Blerim Murina (DIK); dhe
- Arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.108, datë:23.06.2026

Në mbështetje të nenit 13, 14, 17, shkronja a) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja h) dhe n), nenit 70 paragrafi 70.1, shkronja b) dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe në bazë të Thirrjes Publike Sh.12.Nr.16000, datë 12.06.2026 për dhënien në shfrytëzim të shtandeve mobile për plasimin e prodhimeve vendore, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve në kuadër të Thirrjes Publike Sh.12.Nr.16000, datë 12.06.2026 për dhënien në shfrytëzim të shtandeve mobile për plasimin e prodhimeve vendore

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të paraqitura në kuadër të Thirrjes Publike Sh.12.Nr.16000, datë 12.06.2026 për dhënien në shfrytëzim të shtandeve mobile për plasimin e prodhimeve vendore, me këtë përbërje:
 - 1.1. Qendresa Kastrati (DZHED), Kryesuese;
 - 1.2. Valdete Sopi (DZHED), Anëtare;
 - 1.3. Sami Morina (DSHPAIE), Anëtar;
 - 1.4. Enis Fazliu (ZK) – Anëtar rezervë (Zëvendëson anëtarin e rregullt në rast të konfliktit të interesit).
2. Komisioni ka për detyrë shqyrtimin administrativ dhe vlerësimin e aplikacioneve të paraqitura, verifikimin e përmbushjes së kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në Thirrjen Publike, si dhe hartimin e listës së përfituesve me rekomandimet përkatëse.
3. Komisioni zhvillon punën e tij në mënyrë të paanshme, transparente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e përcaktuara në Thirrjen Publike.
4. Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, Komisioni i paraqet Kryetarit të Komunës raportin përfundimtar me rekomandimet përkatëse.
5. Mandati i Komisionit zgjat deri në përfundimin e të gjitha veprimeve që lidhen me procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

6. Vendimit i bashkëngjitet kopja e Thirrjes Publike Sh.12.Nr.16000, datë 12.06.2026 për dhënien në shfrytëzim të shtandeve mobile për plasimin e prodhimeve vendore.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Nënkryetares;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë; dhe
- QSHQ – arkivit.



Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Republika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 16926
Nr./faq. 1 Data 24.06
Br./Str. Datun
No./Pg. Dittë

KAMENICË - KAMENICA 2026



Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.121 datë:23.06.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02 Nr.16592 e datës 19.06.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohen menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës me titull: "**Furnizim me uniforma për shkolla të mesme.**", me numër të kontratës **KM653- 26-3028-1-2-1** në vijim:
 - 1.1. **Z. Shefik Rrudhani (DKA), CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 **Z. Sabit Zylfijaj (DKA), CAKTOHET** mbikëqyrëse i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Shefik Rrudhani (DKA);
- z. Sabit Zylfijaj (DKA); dhe
- QSHQ-arkiv

Kryetari i Komunës




Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës

Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.109, datë:23.06.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Vendimi bazë Sh.02.Nr.39621, i datës 30.11.2023 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxherit të Kontratës, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.Nr.13320, i datës 25.04.2024, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.Nr.5386, i datës 06.03.2025, Kërkesës me numër Sh.08.Nr.16637 të datës 22.06.2026 e parashtruar nga menaxheri i kontratës z. Imran Morina, drejtuar Kryetarit të Komunës, Kërkesa e parashtruar përmes Email-it Zyrtar nga menaxheri i kontratës z. Imran Morina ndaj Studios projektuese DEA Group, Email-it Zyrtar nga Studio projektuese DEA Group për Aprovimin e Kërkesës për Ndryshimin e Pozicioneve Brenda Kontratës dhe Email-it Zyrtar nga Kryetari i Komunës për Aprovimin e Kërkesës për Ndryshimin e Pozicioneve Brenda Kontratës, si dhe neni 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për lejimin e ndryshimeve (aprovimeve) në projekt

1. Miratohet kërkesa e menaxherit të kontratës Z.Imran Morina, për aprovimin e ndryshimeve në projektin: **"Rregullimi i Infrastrukturës në Rrugën Kryesore , Tranzitin në Qytetin e Kamenicës dhe Asfaltimi i Rrugës Mihaj Grameno në Kamenicë- Ritenderim"**, me Nr. të prokurimit: **KM:653-23-11415-5-1-1/C512**.
2. Ndryshimi i sasive në pozicione brenda kontratës është inicuar nga menaxheri i kontratës z.Imran Morina për projektin e sipërcekur lidhur me ndryshimet në këtë projekt dhe e njëjta është aprovuar nga Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e nenit 71 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyra e Prokurimit, Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës.
4. Kryetari i Komunës bazuar në kërkesën e lartcekur vendosi si në pikën (1) një të këtij vendimi.
5. Vendimit i bashkangjiten Kopjet nga Vendimi bazë Sh.02.Nr.39621, i datës 30.11.2023 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxherit të Kontratës, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.Nr.13320, i datës 25.04.2024, i

plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.Nr.5386, i dates 06.03.2025, Kërkesës me numër Sh.08.Nr.16637 të datës 22.06.2026 e parashtruar nga menaxheri i kontratës z. Imran Morina, drejtuar Kryetarit të Komunës, Kërkesa e parashtruar përmes Email-it Zyrtar nga menaxheri i kontratës z. Imran Morina ndaj Studios projektuese DEA Group, Email-it Zyrtar nga Studio projektuese DEA Group për Aprovimin e Kërkesës për Ndryshimin e Pozicioneve Brenda Kontratës dhe Email-it Zyrtar nga Kryetari i Komunës për Aprovimin e Kërkesës për Ndryshimin e Pozicioneve Brenda Kontratës.



6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkyetares, Zyrës për Informim, Zyrës së Prokurimit, Operatorit ekonomik Studio Projektuese DEA Group, Menaxherit të kontratës z. Imran Morina dhe QSHQ – Arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.111, datë: 24.06.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e Rregullores së MAPL-së Nr. 02/2021 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunës, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 70 paragrafi 70.1 shkronja b) dhe nenin 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, me qëllim të hartimit të Draft-Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve në Komunën e Kamenicës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Draft-Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve

1. **FORMOHET** Grupi Punues për hartimin e Draft-Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, në këtë përbërje:
 - 1.1. Qëndresa Kastrati (DZHED), kryesuese;
 - 1.2. Arben Hoxha (DBF), anëtar;
 - 1.3. Nevzadije Shala (DBPZHR), anëtare;
 - 1.4. Hysen Jerliu (DSHPAIE), anëtar;
 - 1.5. Ilirida Zubaku (DPKGJ), anëtare;
 - 1.6. Visar Krasniqi (DKA), anëtar;
 - 1.7. Venera Dërmaku (DKRS), anëtare;
 - 1.8. Durim Biqkaj (DSHMS), anëtar;
 - 1.9. Arif Skoverqani (DUPH), anëtar;
 - 1.10. Sabile Kastrati (DAP), anëtare; dhe
 - 1.11. Valdete Berisha Murina (ZK), anëtare.
2. Grupi Punues është përgjegjës për hartimin e Draft-Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, koordinimin e procesit të konsultimeve me drejtoritë komunale, shqyrtimin e komenteve dhe propozimeve të pranuar, organizimin e konsultimit publik, hartimin e raportit të konsultimit publik, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për përfundimin e procedurës së hartimit të aktit normativ.
3. Grupi Punues, gjatë hartimit të Draft-Rregullores, duhet të sigurojë që dispozitat e saj të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, llogaridhënies dhe menaxhimit të drejtë të mjeteve publike.


4. Mandati i Grupit Punues zgjat deri në përfundimin e procedurave të hartimit dhe konsultimit publik të Draft-Rregullores, miratimin e saj nga Kuvendi i Komunës dhe përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ligjshmërisë sipas legjislacionit në fuqi.
5. Të gjitha drejtoritë komunale obligohen të ofrojnë mbështetjen e nevojshme profesionale dhe administrative për Grupin Punues gjatë ushtrimit të detyrave të tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Nënkyetares;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Drejtorive Komunale; dhe
- QSHQ – arkivit.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj





Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.112, datë: 25.06.2026


Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) dhe nenin 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe bazuar në kërkesën e datës 19.06.2026 të paraqitur përmes postës elektronike zyrtare, me qëllim të kryerjes së pranimin teknik të projektit, Kryetari i Komunës nxjerr:

Vendim

për formimin e Komisionit për Pranimin Teknik të Punimeve

1. Formohet Komisioni për Pranimin Teknik të Punimeve për projektin: “Ndërtimi i Varrezave të Dëshmorëve në Kamenicë”, në këtë përbërje:

- 1.1. Imran Morina (Drejtorja për Investime Kapitale), Kryesues;
- 1.2. Vlonë Matoshi (Drejtorja për Investime Kapitale), Anëtare;
- 1.3. Alban Hashani (ZK), Anëtar;
- 1.4. Mehmet Thaçi (DUPH), Anëtar;
- 1.5. Syhana Latifaj (DPKGJ), Anëtare;
- 1.6. Driton Sylaj (DPKGJ), Anëtar.




2. Komisioni obligohet të kryejë kontrollimin dhe pranimin teknik të punimeve të realizuara në kuadër të projektit nga pika 1 e këtij Vendimi, të verifikojë përputhshmërinë e tyre me kontratën, dokumentacionin teknik, paramasën dhe parallogarinë, si dhe me legjislacionin në fuqi.
3. Komisioni është i autorizuar të kërkojë dhe të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin teknik dhe kontraktual të nevojshëm për realizimin e detyrave të tij.
4. Pas përfundimit të procedurës së pranimin teknik, Komisioni obligohet të hartojë Procesverbalin e Pranimin Teknik dhe Raportin Përfundimtar me konstatimet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat i paraqiten Kryetarit të Komunës.
5. Në rast të konstatimit të mangësive ose mospërputhjeve, Komisioni obligohet t'i evidentojë ato në procesverbal.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen anëtarët e Komisionit të emëruar sipas pikës 1 të këtij Vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Nënkryetares, Zyra e Informimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Q.SH.Q - arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.125 datë: 26.06.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02, Nr.16937 e datës 24.06.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxhere e kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "**Zipstop (servis) dhe Inspektimi periodik i zipline (licenca)**", me numër të kontratë **KM653-26-4046-2-3-6** si në vijim:

1.1. Znj. Amire Ismajli Rexha (DIK), CAKTOHET menaxhere e Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2.Menaxherja e kontratës obligohet të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në përputhje me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe me Manualët për Përdorimin e Modulit për Menaxhimin e Kontratave.

3. Menaxherja e kontratës obligohet të dërgojë raporte të rregullta për procesin e përmbushjes së kontratës.

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- Znj. Amire Ismajli Rexha (DIK) dhe
- QSHQ-arkivi.


Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRADANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 02 Nr./Br./No. 17280
Nr. flet. 01 Data: 29/06/2026
Br. Str. Datum:
No. Pg. Data:

KAMENICE KAMENICA

Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.127 datë:26.06.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02 Nr.17028 e datës 25.06.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohen menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës me titull: **"Furnizim me tepih, perde dhe roleta për shkolla me numër të kontratës KM653- 26-2518-1-2-1 në vijim:**
 - 1.1. **Z. Shefik Rrudhani (DKA), CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 **Z. Sabit Zylfijaj (DKA), CAKTOHET** mbikëqyrëse i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Shefik Rrudhani (DKA);
- z. Sabit Zylfijaj (DKA); dhe
- QSHQ-arkiv


Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E KAMENICES
KRYETARI I KOMUNES
REKORDNIK OPSTINE
KAMENICA
REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF KAMENICA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Prokurimit

Sh.02.Nr.126 datë:26.06.2026

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 70 paragrafi 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, datë 20.10.2022, Kontratës Sh.02 Nr.16942 e datës 24.06.2026, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Nr. Sh.01.nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohen menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës me titull: **"Furnizim me veturë për Administratë jashtë listës së AQP-së"**, me numër të kontratës **KM 653- 26-3237-1-2-1** si në vijim:

1.1. Z. Arben Hoxha (DBF), ÇAKTOHET menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2 Z. Hysen Jerliu (DSHPAIE), ÇAKTOHET mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.

3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:



- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Arben Hoxha (DBF);
- z. Hysen Jerliu (DSHPAIE); dhe
- QSHQ-arkiv

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.121, datë: 30.06.2026

Në vështrim të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), neni 3, nenit 5 paragrafët 1 dhe 4, nenit 7 paragrafi 6, nenit 8, nenit 11 dhe nenit 12 të Rregullores Sh.01.Nr.31251 të datës 29.09.2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Sh.01.Nr.8620, datë 14.04.2025, Vendimit Sh.02.Nr.13368 të datës 20.05.2026 për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencione të paraqitura në Zyrën e Kryetarit, Kërkesa Sh.02.Nr.16678 e datës 22.06.2026, e parashtruar nga Endrit Beqiraj, Kryetar i Këshillit Lokal në fshatin Kopërnice, Komuna e Kamenicës, Rekomandimi Sh.02.Nr.17448 i datës 30.06.2026 të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencione të paraqitura në Zyrën e Kryetarit, si dhe neni 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet rekomandimi Sh.02.Nr.17448, i datës 30.06.2026, i nxjerrë nga Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencione të paraqitura në Zyrën e Kryetarit, në bazë të kërkesës Sh.02.Nr.16678, të datës 22.06.2026, të parashtruar nga Endrit Beqiraj, Kryetar i Këshillit Lokal në fshatin Kopërnice, Komuna e Kamenicës, me ç'rast ndahen mjete financiare në vlerë prej 500.00 € (pesëqind euro) për subvencionimin e manifestimit tradicional "Takimet e Vendlindjes 2026".
2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 16029 Zyra e Kryetarit, në xhirollogarinë bankare të paraqitur, e cila është e bashkangjitur si shtojcë e këtij vendimi.
3. Përgjegjës për zbatimin e vendimit është Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, kurse mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit e bën Kryetari i Komunës.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë Rekomandimi Sh.02.Nr.17448, i datës 30.06.2026, i nxjerrë nga Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencione të paraqitura në Zyrën e Kryetarit dhe Kërkesa Sh.02.Nr.16678, e datës 22.06.2026, e parashtruar nga Endrit Beqiraj, Kryetar i Këshillit Lokal në fshatin Kopërnice, Komuna e Kamenicës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkryetares, Zyrës për Informim, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe QSHQ - arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

